



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 850/1 prot.

Tiranë, më 07. 07. 2025

V E N D I M

Nr. 162, datë 07. 07. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 131, datë 29.05.2025, të A. P., kundër Shoqërisë Stone Works shpk, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *“Punoj prej më shumë se 20 vitesh pranë subjektit Stone Works shpk dhe për shkak të diskutimeve që kam pasur në kantierin e gurores, me përgjegjësin e kantierit, i cili ndodhet në Qafën e Devrisë në rrethin e Skraparit, ky i fundit në muajin prill nuk më lejoi të punoja te vendi i punës ku unë isha kontraktuar, por më detyroi të shkoja te një vend tjetër pune në sharrë, aty ku punojnë punëtorët e thjeshtë. E gjithë kjo siç ai shprehej “për të më ulur hundën”. Unë refuzova të shkoja në një vend pune për të cilin ishte i kundërt me atë që kisha lidhur kontratë, dhe nga ana e tij më është shprehur, “O do punosh këtu ku të them unë, o ik merr këmbët nga ke ardhur, këtu komandoj unë”. Nisur nga këto padrejtësi që po më bëheshin, dhe ky persekutim i vazhdueshëm, unë i jam drejtuar me e-mail firmës, Stone Works më datë 25.04.2025 dhe që prej këtij momenti ka nisur një kalvar i gjatë diskriminimi në punë i kryer nga firma dhe nga përgjegjësi i kantierit.*

Së fundmi në datë 22.05.2025, pas diskutimeve të zhvilluara me punëdhënësin, unë jam paraqitur në punë, por nga ana e përgjegjësit të kantierit përsëri jam ndaluar të punoj aty ku firma më kishte caktuar, dhe jo vetëm kaq, por nuk mu dha as radio komunikimi dhe nuk mu lejua as të vendosja ushqimin në frigorifer por ta mbaja në diell. Përveç kësaj, mu tha që nuk do flija më në vendin ku flija zakonisht, por do më dërgonte në vend tjetër, veçmas nga kolektivi i punës, ku unë kam punuar dhe fjetur me ta prej 20 vitesh”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e punëdhënësit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr. 131, datë 29.05.2025, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë për të vijuar më tej shqyrtimin e saj.

Për rrjedhojë, përmes e-mail-it datë 09.06.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua subjektit ankues duke i kërkuar informacion lidhur me identifikimin e shkakut të pretenduar të diskriminimit, si dhe lidhjen e tij me subjektin kundër të cilit është drejtuar ankesa.

Në përgjigje sa më sipër, me e-mail-in e datës 25.06.2025, nga ana e ankuesit është përcjellë një Deklaratë për heqje dorë nga ankesa nr. 131, datë 29.05.2025, në të cilën ai është shprehur ndër të tjera se: *“... Ju dërgoj këtë email, në dijeninë tuaj, pasi unë do të heq dorë nga ankesa ime dhe arsyeja*

është se unë e kam zgjidhur konfliktin me ish punëdhënësin tim me marrëveshje, e cila ka hyrë në fuqi ditën e premte dt. 20 Qershor 2025, dhe është ekzekutuar totalisht detyrimi i lindur nga kjo marrëveshje ditën e hënë dt. 23 Qershor 2025. Për këtë arsye, për shkak se çështjen, konfliktin e kemi zgjidhur me marrëveshje, ju kërkoj të mos vazhdoni më me këtë procedurë ankimore timen, dhe të arkivoni dosjen...”

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94¹/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, A. P., i cili, me anë të kërkesës së tij të përcjell përmes e-mail-it datë 25.06.2025, është tërhequr nga ankesa e tij pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesi në datën 25.06.2025, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 131 regj., datë 29.05.2025, të paraqitur nga ankuesi A. P., kundër Shoqërisë Stone Works shpk, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

¹ “Tërheqja e ankesës”.

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 131 Regj., datë 29.05.2025, të A. P., për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)